

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. Sh. nga fshati L., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.378/2016, të datës 31.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 13.04.2017, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar KEDS-Distrikti në Gjakovë, B. J. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L. SH., nga i ati H., e ëma Z., e gjinisë K., i lindur me datën ..., në fshatin L., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë të pavërtetuar e gjerë me datën 16.04.2015, në lokalin e tij restorant, në fshatin L., Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr.15818984, përmes kabllos 5x2.5 ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik, me çka ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS-Distrikti në Gjakovë me rastin e kryerjes së kontrollës, me ç ‘rast të dëmtuarës KEDS-Divizioni i Rrjetit- Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 1.181,12 €uro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 320 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) €uro dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër penale.

Obligohet i akuzuari L. Sh., që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 €uro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 378/2016, të datës 31.10.2016, kundër të akuzuarit L. Sh. nga fshati L., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i Shtetit Ismet Tofaj gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit L. Sh. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari L. Sh., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se është penduar thellë për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla duke theksuar se dëmin e shkaktuar me këtë veprë penale në tërësi ia ka kompensuar të dëmtuarës.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, duke dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe në faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar KEDS-Distrikti në Gjakovë, B. J., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë por si palë e dëmtuar në këtë raste e njoftoi gjykatën se i akuzuari në tërësi e ka paguar dëmin e shkaktuar me këtë veprë penale andaj gjykatës ia dorëzoi një kopje të transaksionit të konsumatorit ku i njëjti ka borxh vetëm 0.30 cent, andaj si palë e dëmtuar për këtë raste nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike meqenëse i njëjti ka kompensuar në tërësi dëmin.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari L. Sh., në mes të datës së pavërtetuar e deri me datën 16.04.2015, në lokalin e tij restorant, në fshatin L., Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr.15818984, përmes kabllos 5x2.5 ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik, me çka ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS-Distrikti në Gjakovë me rastin e kryerjes së kontrollës, me ç ‘rast të dëmtuarës KEDS-Divizioni i Rrjetit-Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 1.181,12 €uro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraparë në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, është baba i tre fëmijëve, është mbajtës i familjes 5 anëtarësh, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, do të jetë më i kujdesshëm, faktin se në tërësi e ka kompensuar palën e dëmtuar për dëmin e shkaktuar me veprën penale si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata nuk e udhëzoi të dëmtuarën KEDS-Distrikti në Gjakovë, në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, ngase përfaqësuesi i sajë i autorizuar B. J. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se si palë e dëmtuar nuk parashtrijmë kërkesë pasurore-juridike meqenëse i akuzuari në tërësi e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me këtë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.2 pika 2.6 në lidhje me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.670/16, me datë 13.04.2017

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.